

## **Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil merr pjesë në Sesionin e Aktiviteteve të Kongresit Botëror të Ligjit**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), mori pjesë në sesionin hapës të aktiviteteve të Kongresit Botëror të Ligjit, që u zhvillua në Tiranë, nën kujdesin e Shoqatës Botërore të Juristëve dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë së Shqipërisë.



Ky aktivitet i nivelit të lartë mbledhi përfaqësues të qeverisë, gjyqtarë ndërkombëtarë, drejtues institucionesh ligjore dhe akademike nga mbarë bota, duke e kthyer Tiranën në një pikë takimi për dialogun mbi drejtësinë, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.



Sesioni hapës shënon nisjen e një serie aktivitetesh që do të kulmojnë me organizimin e Kongresit Botëror të Ligjit në Tiranë në vitin 2027.